

Bashkia Shkodër

Nr. 467 prot, datë 19/01/2019

DRSHSSH Shkodër

Nr. 55 prot, date 14/01/2019

Shtëpia e Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër

Nr. 6 prot, datë 17/01/2019

Nisma për ndryshim shoqëror-ARSIS

Nr. 04 prot, datë 17/01/2019

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë 17 janar 2019 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

1. **Bashkia Shkodër** me adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, Shqipëri, përfaqësuar nga *Kryetarja, Znj. Voltana Ademi*, në vijim e cilësuar si **"Bashkia"**,
2. **Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social Shtetëror Shkodër**, këtej e tutje e quajtur **DRSHSSH**, me adresë Lagja "Qemal Stafa", rruga "Vasil Shanto", Pallati i ri, kati i parë, Kodi Postar 4001, Shkodër, përfaqësuar nga *znj. Valbona Tula*, drejtore, mbajtëse e letërnjoftimit biometrik (ID Card) me numër H05316131D,
3. **Institucioni i Përkujdesit Shoqëror, Shtëpi Fëmijë 16-18 vjeç, Shkodër**, këtej e tutje e quajtur **"IPSH"**, me adresë: Rruga "Skanderbeg", Kodi Postar 4001, përfaqësuar nga Drejtore, *znj. Rezarta Pode*, mbajtëse e letërnjoftimit biometrik (ID Card) me numër H05815106J,
4. **Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS**, këtej e tutje e quajtur shkurtimisht **NISMA ARSIS**, përfaqësuar nga Drejtore Ekzekutive *znj. Ana MAJKO* mbajtëse e letërnjoftimit biometrik (ID Card) me nr. 024789337.

Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Shkodër, DRSHSSH Shkodër, IPSH 16-18 vjeç Shkodër, Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS - Janar 2019

Faqe 1 nga 7



NISMA ARSIS është organizatë jo-fitimprurëse, regjistruar si person juridik sipas vendimit nr. 5260, datë 18 shkurt 2016, të Gjykatës së Rrethit të Parë Tiranë, me NIPT L611429451E, me numër license LN-1238-03-2016, me adresë: Rruga e Kavajes, Pallati A, Shkalla 3, Ap.27 Njesia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana, Albania.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka ndërmarrë "Nismën për të vlerësuar fëmijët e ndodhur në Institucionet Publike të Përkujdesit Shoqëror dhe planifikimin e ribashkimit të tyre me familjet biologjike ose vendosjen në shërbime të tjera alternative të përkujdesit, këtë e tutje quajtur "Proçes i vlerësimit", si një bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, UNICEF dhe Save the Children,

- UNICEF ka kontraktuar NISMA ARSIS për të realizuar vlerësimin e fëmijëve në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror dhe të familjeve të tyre pranë vendodhjes së tyre me qëllim planifikimin e ribashkimit mes tyre ose gjetjen e alternativave të tjera si kujdestaria alternative në familje me /pa lidhje gjaku etj.
- NISMA ARSIS është aktor kyç:
  - në ndërhyrjet në terren (punën në rrugë, në familje dhe komunitet),
  - në menaxhimin e rasteve dhe fuqizimin e familjes,
  - në hartimin dhe zbatimin e protokolleve për vlerësimin e fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre,
  - zotëron burimet njerëzore me eksperiencë në vlerësimin e fëmijëve dhe familjeve, burime materiale, logjistike, ekspertizën, metodologji dhe plan veprimesh për proçesin e vlerësimit.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

#### **NENI 1: Objekti dhe Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që në lidhje me zbatimin e proçesit të vlerësimit të:

- o sigurojë mbikqyrjen e duhur për zhvillimin në kohë, sasi dhe në cilësi të veprimtarive të planifikuara,
- o arrijen e objektivave dhe rezultateve të parashikuara.

Marrëveshja ka si objekt të saj të:

- përcaktojë mjetet, burimet njerëzore dhe financiare të zbatimit,
- ndajë qartazi detyrat dhe përgjegjësitë,
- përcaktojë mënyrat e bashkëpunimit të efektshëm mes palëve.

Në kuadër të "Proçesit të vlerësimit", NISMA ARSIS do të ofrojë të gjithë eksperiencën dhe ekspertizën e tetë ekspertëve në fushën e vlerësimit dhe mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri për fëmijët e ndodhur në Institucionet Publike të Përkujdesit Shoqëror dhe planifikimin për ribashkimit me familjet e tyre ose alternativave të tjera të përkujdesit.

Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Shkodër, DRSHSSH Shkodër, IPSH 16-18 vjeç Shkodër, Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS - Janar 2019

Faqe 2 nga 7



## **NENI 2: Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në legjislacionin në fuqi veçanërisht në:

- Ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e Fëmijëve";
- Ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë",
- VKM nr. 578 dt. 03.10.2018 "Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".
- VKM nr. 518 datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar/rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre në masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar;
- VKM nr.659 datë 17.10.2005, "Për standartet e Shërbimeve Shoqërore për fëmijët në institucionet e përkujdesit shoqëror"
- VKM nr.425 dt.27.06.2012 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore" shoqëruar me ndryshimet përkatëse.

## **NENI 3: Kohëzgjatja dhe disponueshmëria**

- a. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhën nga data 01 janar 2019 deri me datë 30 Tetor 2019, me të drejtë përtëritjeje;
- b. NISMA ARSIS do të jetë e disponueshme përkundrejt kontroleve audituese, çdo raportim, detyrim, monitorim apo vlerësim të brendshëm apo të jashtëm që lind nga zbatimi i Marrëveshjes.

## **NENI 4: Veprimtaritë dhe shërbimet që do të ofrohen**

Për realizimin e procesit të vlerësimit palët do të angazhohen:

### **Bashkia**

- a) Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki, në vëmendje Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, do të jetë struktura mbështetëse e procesit të vlerësimit (punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve do të shërbejë si pikë kontakti për procesin e vlerësimit);
- b) Përfaqësues të bashkisë do të marrin pjesë në takime koordinuese në nivel lokal dhe vendor për të ndjekur sfidat dhe vështirësitë e procesit të vlerësimit;

Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Shkodër, DRSHSSH Shkodër, IPSH 16-18 vjeç Shkodër, Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS - Janar 2019

Faqe 3 nga 7



- c) Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve / Administratorët Socialë do të lehtësojnë vizitat në familje për familjet e origjinës së fëmijëve të vendosur në Institucionin e Përkujdesit Shoqëror (të cilat janë banorë të kësaj bashkie)
- d) Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki do të sigurojë informacion për shërbimet që përfitojnë aktualisht dhe kanë përfitur më parë familjet e origjinës së fëmijëve të vendosur në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, (të cilat janë banorë të kësaj bashkie)
- e) Përfaqësuesit e Bashkisë do të sigurojnë listën e familjeve të mundshme të identifikuar si kinship<sup>1</sup>/familje kujdestare në secilën njësi administrative brenda territorit të tyre;
- f) Përfaqësuesit e Bashkisë do të sigurojnë informacionin që lidhet me Planin Social të Veprimit/Planin Social të Mbrojtjes (në rast se e kanë të hartuar dhe miratuar).

#### **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror**

- a) Do të njoftojë për çdo fëmijë të ri të vendosur në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror gjatë zbatimit të procesit të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve;
- b) Përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror do të jenë pjesë mbështetëse e ekipit të vlerësimit në gjithë procesin e tij, pjesë e tryezave teknike dhe ndarje e ekspertizës sipas nevojës.
- c) Shërbimi Social Shtetëror do të mbështesë në vlerësimin e familjeve të fëmijëve me informacion, sidomos në rastet kur nevojitet bashkëpunimi ndërbashkiak.

#### **Institucioni i Përkujdesit Shoqëror**

- a) IPSH do të përgatisë listën e fëmijëve që janë të vendosur pranë tij<sup>2</sup>;
- b) IPSH do të përgatisë listën e familjeve të fëmijëve, me të dhëna të detajuara të familjarëve, kontaktet përkatëse, vendndodhjet sipas gjendjes civile, vendqëndrimet kur është rasti, duke u bazuar në informacionet që disponojnë nga dokumentat dhe kontaktet;
- c) Do të mundësojë si fillim një takim me familjarët (prindërve biologjik/kujdestarëve ligjorë) e çdo fëmije, gjithmonë kur është e mundur, i cili do të zhvillohet në ambientet e institucionit, me palë prindërit, stafin e institucionit dhe përfaqësues të NISMA, pasi të ketë përfunduar procesi i vlerësimit të fëmijëve dhe përpara se të fillojë vlerësimi në terren i familjeve.
- d) IPSH do të përgatisë listën e fëmijëve që janë të braktisur nga prindërit e tyre biologjikë dhe që janë në proces birësimi;

<sup>1</sup> familje me lidhje gjaku

<sup>2</sup> Kjo e dhënë paraprake ndihmon në përgatitjen e planit të punës dhe kalendarit të vlerësimit për çdo fëmijë në institucionet rezidenciale.



- e) IPSH do të përgatisë listën e fëmijëve, kujdestar ligjor të cilëve është Institucioni i Përkujdesit Shoqëror;
- f) IPSH do të përgatisë listën e fëmijëve që kanë kontakt të vazhdueshëm me prindërit e tyre dhe lista e atyre fëmijëve që nuk kanë kontakt me prindërit;
- g) IPSH do të sigurojë një ambjent miqësor për të zhvilluar takime/vlerësime individuale të fëmijëve si dhe takime në grup;
- h) IPSH do të sigurojë akses për ekipin e vlerësuesve për të zhvilluar vëzhgime gjatë aktiviteteve rutinë të fëmijëve brenda institucionit;
- i) IPSH do të sigurojë informacion në lidhje me gjendjen shëndetsore, shëndetin mendor dhe fizik më të fundit për çdo fëmijë të vendosur në këtë institucion

#### **NISMA ARSIS**

- a) do të sigurojë mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit gjatë gjithë procesit të vlerësimit;
- b) do të përgatisë një listë me të dhënat e stafit dhe kontaktet e tyre si dhe me të dhëna mbi sigurinë (dëshmia e penalitetit dhe librezat shëndetsore, kontrata e shërbimit, politikat e mbrojtjes së fëmijëve, kodi i etikës);
- c) do të përgatisë planin e punës dhe kalendarin të lëvizjeve duke e ndarë me të gjithë palët e përfshira;
- d) do të zhvillojë takime koordinuese mujore në nivel teknik dhe tre mujore në nivel drejtuesish midis 4 palëve të përfshira në marrëveshje për të ndarë sfida dhe vështirësi gjatë procesit të vlerësimit të fëmijëve dhe familjeve;
- e) do të adresojë çdo sfidë pranë grupit të ngritur në MSHMS me përfaqësues nga MSHMS, UNICEF, Save the Children, me qëllim trajtimin e tyre dhe arritjen e rezultateve pozitive
- f) Do të raportojë çdo rast të fëmijëve që gjatë procesit të vlerësimit dyshohet/identifikohet si viktimë dhune, keqtrajtimi, neglizhimi, etj apo vlerësohet me diagnoza të papërcaktuara apo njohura më parë.

#### **NENI 5: Burimet materiale dhe njerëzore të disponueshme**

Për zbatimin e procesit të vlerësimit, NISMA ARSIS do të vendosë në dispozicion si më poshtë:

- Burimet materiale të nevojshme për realizimin e procesit të vlerësimit (automjet, kompjutera dhe bazë materiale, instrumentat përkatës për vlerësimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre);
- Stafin ku përfshihet: 6 ekspertë, psikologë dhe punonjës social, 1 team leader dhe 1 supervisor i shërbimit psikologjik.



#### **NENI 6: Personat e Kontaktit**

- a. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:
  - Për Bashkinë: Znj. Vilma Shiroka,
  - Për DRSHSSH: Z. Eltjon Boshti,
  - Për IPSH: Z. Julian Jana dhe Z. Arjet Pervizi,
  - Për NISMA ARSIS: Znj. Julinda Vokopola
- b. Këta persona do të jenë përgjegjës gjithashtu dhe për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me Projektin.
- c. Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### **Neni 7: Ndërprerja e njëanshme**

Nëse ka prova të qëndrueshme atëherë secila palë ka të drejtën të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e bashkëpunimit me efekt të menjëhershëm.

Në rast se ndonjëra ose të katërta palët nënshkruese e kanë të pamundur përmbushjen e kushteve të marrëveshjes për shkaqe madhore atëherë asnjëra palë nuk do të konsiderohet në kushtet e thyerjes së detyrimeve. Forca madhore përfshijnë gjendje të jashtëzakonshme të paparashikuara ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, gjendje që nuk shkaktohen për shkak të veprimeve/mosveprimeve apo çdo lloj faji nga ana e tyre që provohet i pakapërcyeshëm.

#### **NENI 8: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni mbi palët që do të ndihmojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

#### **NENI 10: Dispozita të fundit**

- a. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 3 dhe në dokumentin e procesit të vlerësimit;
- b. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë çdo detyrim që rrjedh nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve, për zbatimin e procesit të vlerësimit për fëmijët dhe planifikimin për ribashkimin me familjarët e tyre apo alternativave të tjera të përshtatshme të kujdesit alternativ.
- c. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga secila palë;
- d. Pjesë përbërëse dhe të pandara të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, janë shtojcat (Plani i Veprimit) bashkëlidhur saj;

Marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë Shkodër, DRSHSSH Shkodër, IPSH 16-18 vjeç Shkodër, Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS - Janar 2019

Faqe 6 nga 7



- e. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Ajo hartohet në tetë kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë. Marrëveshja nënshkruhet nga palët me vullnet të lirë dhe vetëdije të plotë.

Bashkia Shkodër  
Znj. Voltana ADEMI



Drejtoria Rajonale e SHSSH Shkodër  
Znj. Valbona TULA



Shtëpia e Fëmijës 16-18 vjeç, Shkodër

Znj. Rezarta PODE



Nisma për Ndryshim Shoqëror  
ARSIS  
Znj. Ana MAJKO



korre. J. Xhabija  
djsh.